



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 76, datë 29.06.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “MBI LICENCIMIN E AKTUARËVE TË
AUTORIZUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Në rregulloren “Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit”, të miratuar me Vendimin nr. 67, datë 27.07.2009, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, bëhen këto ndryshime:
 - a. Titulli i rregullores ndryshohet si më poshtë vijon:
“Mbi autorizimin e aktuarëve të shoqërive të sigurimit”
 - b. Paragrafi i parë i nenit 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Personi që kërkon të pajiset me autorizim për të kryer veprimtarinë e aktuarit në sigurime i quajtur në këtë rregullore aplikanti duhet të plotësojë:”
 - c. Pika I, e nenit 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“I. Kriteret e profesionalizmit
 1. *Të ketë përfunduar studimet e larta me titullin matematikan ose studimet e larta në fusha të tjera, si dhe*
 2. *të ketë mbaruar studimet për shkencë aktuariale jashtë vendit, ose të zotërojnë certifikatë të aktuarit të lëshuar prej një organizate të njohur profesionale, pas kryerjes me sukses të ciklit të plotë të testimit aktuarial.*
 3. *Të ketë eksperiencë profesionale në fushën e sigurimeve.*
 4. *Të kalojë me sukses testimin e organizuar nga Autoriteti.”*
 - ç. Pika b, paragrafi II i nenit 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“b. Diplomë për përfundimin e studimeve të larta në shkencat aktuariale ose Certifikata të aktuarit të lëshuar nga një organizatë e njohur profesionale;”
 - d. Pika 1, e nenit 6 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Të gjithë deklaratat dhe kopjet e dokumentave të kërkuara sipas kësaj rregullore duhet të jenë në gjuhën origjinale. Për dokumentin, gjuha origjinale e të cilave është e ndryshme nga shqipja dhe anglishtja, bashkëngjitur me këtë dokument duhet të dorëzohet dhe përkthimi i noterizuar në gjuhën shqipe.”

dh. Pika 2, e nenit 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Procedura e testimit zhvillohet çdo 2 muaj.”

e. Pika 1, e nenit 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Departamenti i Licencimit i propozon Bordit të Autoritetit, për pajisje me autorizim kandidaturat që kanë kaluar me sukses testimin së bashku me dosjen përkatëse.

ë. Pika 2, e nenit 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Afati i vlefshmërisë së autorizimit është 5 vjet.”

f. Neni 9, shtohet pika 3, si më poshtë vijon:

“Autoriteti njeh autorizimin e aktuarit, të lëshuar nga Autoriteti përkatës i një shteti të Bashkimit Evropian dhe/ose i një shteti të miratuar specifikisht nga AMF.”

g. Neni 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Të gjithë shoqëritë e sigurimit detyrohen që pasqyrat e 9-mujorit të vitit 2011 të paraqiten në Autoritet të firmosur nga aktuari i autorizuar.”

gj. Fjala “Kërkuesi” në rregullore zëvendësohet me fjalën “aplikanti”.

2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI